



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

## RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Prishtinë, 2023

Në përputhje me nenin 12, paragrafi 12.2, pika c, nenin 17, pika f, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja a të Ligjit nr. 03/L – 040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), dispozitat e neneve 15 dhe 34 të Ligjit nr. 04/L – 60, për Mbeturina, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 08/L-071 (Gazeta Zyrtare nr. 29, 1 shtator 2012), nenin 8, pika a, nenin 15, pika f dhe 19 paragrafi 1, Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/03 qershor 2008), si dhe nenit 15, pika f, nenit 33, pika a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023, miratoi këtë:

## RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

### Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të rregullojë çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, dhe të përcaktojë lartësinë e taksës për mbeturina në mënyrë që të krijohet një sistem i qëndrueshëm për administrimin financiar mbi menaxhimin e mbeturinave komunale.
2. Aplikimi dhe shtrirja në funksion të sistemit për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave në pjesën urbane dhe rurale në gjithë territorin e Komunës së Prishtinës që nënkupton rregullat përgjegjëse përmes qëndrueshëm të mbeturinave, vendosjen e kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyrën e transportit të tyre.
3. Me këtë rregullore përcaktohet sistemi, orari dhe kushtet për mënyrën e grumbullimit të mbeturinave, vendosjen e kontejnerëve, mirëmbajtjen e vendeve ku grumbullohen ato dhe mënyrën e transportit të tyre.

### Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë obligative për të gjithë qytetarët, bizneset, kompaninë publike përgjegjëse për mbeturina dhe operatorët tjera, si dhe të gjithë atyre që kanë të bëjnë me mbeturina brenda territorit të Komunës së Prishtinës.

### Neni 3 Përkufizimet

1. **Mbeturina** – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

2. **Menaxhim i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin, reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis, shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin, deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.
3. **Operatori** – personi, i cili në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave, si dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.
4. **Licenca për menaxhimin e mbeturinave** – leje me shkrim, e cila lëshohet me vendim të ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas ligjeve në fuqi.
5. **Certifikata për menaxhimin e mbeturinave** – kjo certifikatë iu lëshohet të gjitha bizneseve, të cilat operojnë në Komunën e Prishtinës. Me këtë certifikatë mund të pajisen vetëm ato biznese të cilat i plotësojnë kushtet si në vijim: pajisja (furnizimi) me kontejnerë adekuat (sipas standardeve të përcaktuara) për veprimtarinë biznesore që ushtron, përcaktimi i hapësirës (lokacionit) për vendosjen e këtyre kontejnerëve
6. **Leje për transportimin e mbeturinave ndërtimore** – është leje e cila merret vetëm për objektin specifik dhe vlen vetëm për atë objekt. Kjo leje merret në Sektorin për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit, e cila do t'i specifikojë edhe dokumentet e nevojshme për t'u pajisur me këtë leje. Sektori për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë i njofuar për kohën e përcaktuar nga kompania e cila bën transportimin e mbeturinave ndërtimore nga objekti specifik. Kjo leje mund të revokohet në çdo kohë, në rast se kompania e cila pajiset me të e keqpërdor atë.
7. **Leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave** – është leje e cila lëshohet për të kryer shërbimin e menaxhimit me mbeturina në Komunën e Prishtinës dhe zëvendëson licencën që më parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit.
8. **Person** – person fizik ose juridik, i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, në proceset për menaxhimin e mbeturinave.
9. **Mbledhje** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes, deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.
10. **Prodhuesi i mbeturinës** – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon/prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me paraprocesim, përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.
11. **Zotëruesi i mbeturinës** – prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinën.
12. **Mbeturina komunale** – mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina nga aktivitetet tjera, të cilat

për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

13. **Mbeturina të parrezikshme** – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
14. **Mbeturina komerciale** – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen në mbeturina industriale.
15. **Mbeturina inerte** – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar, si: mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut.
16. **Mbeturinë e vëllimshme** – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.
17. **Qendra e grumbullimit** – lokacionet për grumbullimin e mbeturinave, të ndara sipas llojeve të përcaktuara.

#### Neni 4 Llojet e mbeturinave

1. Llojet e mbeturinave që i menaxhon komuna sipas kësaj rregulloreje janë si në vijim:
  - 1.1 **Mbeturinat komunale** - janë mbeturinat nga amvisëritë dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre mund të janë të ngjashme me ato të amvisërisë. Mbeturinat komunale janë:
    - 1.1.1. Mbeturina inerte – që nuk treten, nuk ndizen dhe nuk kanë si pasojë reagime fizike ose kimike, që nuk kanë zërthim biologjik në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
    - 1.1.2. Mbeturina të vëllimshme – mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe orenditë shtëpiake, mbeturinat me përmassa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë;
    - 1.1.3. Mbeturina nga konstruktim-demolimet dhe mbeturinat tjera të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;
    - 1.1.4. Biombeturinat – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë

dhe mbeturinat e ngjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit.

- 1.2. **Mbeturina komerciale** – mbeturinat të cilat gjenerohen nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por që nuk përfshihen në mbeturina industriale.
- 1.3. **Mbeturina industriale** – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtaria artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese.
- 1.4. **Mbeturina medicinale** – mbeturinat patologjike që krijohen nga aktivitetet medicinale, si dhe materialet tjera që përdoren në shërbimet mjekësore.
- 1.5. **Mbeturina shtazore** – mbeturina të cilat krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitete tjera të ngjashme.

#### **Neni 5 Mbeturinat e përjashtuara**

1. Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
  - 1.1. Mbeturinat e rrezikshme;
  - 1.2. Llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme.
2. Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të udhëzimeve të veçanta administrative përkatëse.

#### **Neni 6 Përgjegjësitë e komunës për menaxhimin e mbeturinave**

1. Përgjegjësitë dhe detyrat e komunës janë:
  - 1.1. Trajtimi i mbeturinave komunale nga konstruktim-demolimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme brenda territorit të komunës.
  - 1.2. Zgjedhja dhe caktimi i vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimi i hapësirave për ndërtim të qendrave më të mëdha për grumbullimin e tyre në vendbanimet periferike të qytetit apo edhe ato rurale.
  - 1.3. Përcaktimi i lokacioneve për vendosjen e kontejnerëve bëhet nga ana e komunës, në bashkëpunim me operatorin ose palët e treta të kontraktuara.
  - 1.4. Përcaktimi i llojit të kontejnerëve të përshtatshëm me teknikën me të cilën bëhet mbledhja,

ndarja dhe transportimi i tyre.

1.5. Përcaktimi i orarit dhe dinamikës i mbledhjes së mbeturinave.

1.6. Sipas nevojës, autorizimi i operatorit që të bëjë mbledhjen e mbeturinave edhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë.

1.7. Monitorimi mjedor i deponisë së mbeturinave.

1.8. Identifikimi i pikave/deponive ilegale të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre.

1.9. Formimi i komisionit në kuadër të administratës komunale për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave të tarifës së paguesve të mbeturinave.

1.10. Sigurimi i kushteve të veprimit dhe operimit për operatorët publik dhe privat.

1.11. Përcaktimi i taksës dhe mënyrës së arkëtimit i mjeteve financiare.

1.12. Promovimi për minimizimin e mbeturinave ripërdorim, reduktim, riciklim të tipit 3R, kompostimit.

1.13. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.

1.14. Përpilimi i raporteve, lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe shkallën e inkasimit të taksës së mbeturinave.

1.15. Dorëzimi i raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për menaxhimin e mbeturinave, çdo 31 mars të vitit pasues.

1.16. Hartimi i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (PKMM).

1.17. Hartimi i raportit vjetor për realizimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave, deri më 31 mars të vitit vijues.

## **Neni 7** **Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave**

1. Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

1.1. Konsumatorët e amvisërive:

1.1.1. të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët;

1.1.2. të shërbyer me shërbimin derë më derë.

**1.2. Konsumatorët komercialë/industrialë:**

- 1.2.1. dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyeze;**
- 1.2.2. subjekte të mesme dhe të mëdha komerciale, me kosto të ulët të shërbimit;**
- 1.2.3. subjekte të mesme dhe të mëdha komerciale, me kosto të lartë të shërbimit.**

**1.3. Institucionet:**

- 1.3.1. konsumatorët e vegjël institucionalë;**
  - 1.3.2. konsumatorët e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë;**
  - 1.3.3. konsumatorët e mëdhenj institucionalë të shërbyer me kontratë.**
- 2. Përshkrimi i detajuar i kategorizimit dhe taksave është i bashkëngjitur si Shtojca 1, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.**

**Neni 8**  
**Të drejtat e gjeneruesve të mbeturinave**

- 1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë që krijojnë mbeturina, kanë të drejtë të kenë qasje në shërbimet publike për hedhjen e mbeturinave.**
- 2. Çdo gjenerues i mbeturinave komunale ka të drejtë ankesë ndaj shërbimit të ofruar, në organet relevante në kuadër të komunës apo tek kompanitë përgjegjëse për bartjen e mbeturinave.**

**Neni 9**  
**Detyrimet e gjeneruesve të mbeturinave**

- 1. Gjeneruesit e mbeturinave duhet të paguajnë për shërbimin e ofruar në bazë të tarifës së miratuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës siç përcaktohet me Shtojcën 1, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.**
- 2. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar të regjistrohen në listat e shërbimit të konsumatorëve, për mbledhjen dhe bartjen e mbeturinave.**
- 3. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat t'i ndajnë dhe t'i vendosin sipas sistemit të përcaktuar nga komuna, si më poshtë:**
  - 3.1. Çdo ekonomi familjare me banim individual/rezidencial obligohet që hedhjen e**

- mbeturinave ta bëjë përmes shportave/kontejnerëve për grumbullimin e mbeturinave;
- 3.2. Gjeneruesit e mbeturinave nga objektet e banimeve kolektive obligohen që hedhjen e mbeturinave shtëpiake ta bëjnë në kontejnerët apo në vendet për mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave;
- 3.3. Çdo biznes obligohet të posedojë shporta për grumbullimin e mbeturinave që krijon;
- 3.4. Shoqërítë që ofrojnë shërbime tregtare, hoteliere dhe shërbime tjera kanë për obligim të mbajnë mjedisin e pastër përreth objekteve, përfshirë edhe trotuarin apo hapësirën para objektit;
- 3.5. Të gjithë gjeneruesit e mbeturinave duhet të bëjnë përpjekje për minimizimin e mbeturinave përmes kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme;
- 3.6. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen t'i mundësojnë qasje operatorit në vendin e dorëzimit të mbeturinave.
4. Bizneset, veprimtaria e të cilave gjeneron paketime nga kartoni, obligohen që përveç kontejnerit për mbeturina tjera, të mbajnë edhe kontejner specifik për ndarjen e paketimeve, i cili duhet të jetë i vendosur afér lokalit dhe duhet të jetë me rrjetë, me hapësirë të dukshme. Bizneset të cilat obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë për paketime janë:
- 4.1. Marketet;
  - 4.2. Pemëshitësit;
  - 4.3. Depot;
  - 4.4. Dyqanet me shumicë;
  - 4.5. Dyqanet me pakicë, të cilat gjenerojnë shumë paketime;
  - 4.6. Qendrat tregtare;
  - 4.7. Dyqane të cilët bëjnë shitje të veshmbathjeve apo produkte tjera të ngjajshme që gjenerojnë shumë paketime;
  - 4.8. Dyqanet të cilat bëjnë shitje të produkteve të teknikës së bardhë dhe produkteve teknologjike.
5. Bizneset, veprimtaria e të cilave gjeneron vajra si mbeturinë, obligohen që të posedojnë kontejnerë të veçantë në të cilët i ndajnë këto mbeturina. Bizneset, të cilat obligohen të posedojnë

kontejnerë të veçantë për grumbullimin e vajit janë:

- 5.1. Restorantet;
- 5.2. Garazhet për rregullimin e automjeteve apo mjetave tjera motorike.
6. Bizneset, veprimtaria e të cilave gjeneron mbetje nga djegiet apo hi si mbeturinë, obligohen që të posedojnë kontejnerë të veçantë në të cilët i ndajnë këto mbeturina. Bizneset, të cilat obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë për grumbullimin e prushit dhe hirit janë:
  - 6.1. Bukëpjekësit të cilët përdorin furra me dru apo thëngjill;
  - 6.2. Qebaptoret të cilat përdorin skara me dru apo thëngjill;
  - 6.3. Restorantet të cilat shfrytëzojnë furra/skara me dru apo thëngjill;
  - 6.4. Bizneset tjera të ngjashme, të cilat gjenerojnë këtë lloj të mbeturinave.
7. Bizneset, veprimtaria e të cilave gjeneron mbeturina të kompostueshme obligohen që të posedojnë kontejnerë të veçantë, në të cilët i ndajnë këto mbeturina. Bizneset të cilat obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë për mbeturina të kompostueshme janë:
  - 7.1. Marketet;
  - 7.2. Pemëshitësit;
  - 7.3. Tregjet.
8. Bizneset, veprimtaria e të cilave gjeneron goma si mbeturinë, obligohen që të posedojnë kontejnerë të veçantë, në të cilët i ndajnë këto mbeturina. Bizneset të cilat obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë për goma janë:
  - 8.1. Vullkanizerët;
  - 8.2. Bizneset të cilat bëjnë përpunimin apo shitjen e gomave;
  - 8.3. Mekanikët.
9. Bizneset, veprimtaria e të cilave gjeneron mbeturina nga mbetjet shtazore obligohen që të posedojnë kontejnerë të veçantë në të cilët i ndajnë këto mbeturina. Bizneset të cilat obligohen të posedojnë kontejnerë të veçantë për mbeturina nga mbetjet shtazore janë:
  - 9.1. Mishtoret;

9.2. Thertoret;

9.3. Fabrikat për përpunimin e mishit dhe të ngashme.

10. Të gjitha bizneset të cilat operojnë në territorin e Komunës së Prishtinës obligohen që të aplikojnë për Certifikatën për Menaxhim të Mbeturinave në Sektorin për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit. Secili biznes, duhet të posedojë një certifikatë të tillë, e cila do të shërbejë si kusht për operim.
11. Të gjitha bizneset të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parapara sipas kësaj rregulloreje për mënyrën e ekspozimit të mbeturinave duhet që në afat prej tre (3) muaj, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje t'i plotësojnë këto kushte. Në rast të mospërbushjes së këtyre kushteve do të konsiderohet që nuk i plotëson kushtet sanitare për operim në territorin e Komunës së Prishtinës.
12. Gjeneruesit e mbeturinave të veçanta si: spitalet, ambulancat dhe objektet tjera për shërbime mjekësore, duhet të përdorin sistemin e ndarë të kontejnerëve me qëllim të ndarjes së mbeturinave medicinale dhe mbeturinave tjera.
13. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre t'i hedhin në vende të caktuara për mbledhjen e mbeturinave, të cilat caktohen nga ana e komunës, ndërsa mbeturinat e rezikshme t'i ndajnë dhe t'i dorëzojnë në pikat mbledhëse apo në vendet e caktuara.
14. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të respektojë rregullat e përcaktuara sipas Planit për menaxhimin e mbeturinave.
15. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave përmes kompostimit dhe formave tjera të mundshme.
16. Çdo gjenerues i mbeturinave obligohet që të largojë mbeturinat, të cilat krijohen gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo demolimit të objekteve nga hapësirat ose vendet publike.
17. Gjeneruesi i mbeturinave ndërtimore gjatë meremetimit apo demolimit të objekteve, obligohet të njoftojë Njësinë e Menaxhimit të Mbeturinave në Komunën e Prishtinës.
18. Komuna e Prishtinës përmes kompanive përgjegjëse obligohet që të ofrojë kontejnerë të veçantë për hedhjen e këtyre mbeturinave brenda afatit të caktuar. Tarifa e këtij shërbimi bëhet në bazë të zbrazjeve të kontejnerëve siç është e përcaktuar në listën e çmimeve të shërbimeve si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
19. Ndërmarrjet industriale obligohen që Komunës së Prishtinës t'ia dorëzojnë Planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilin e gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

20. Çdo gjenerues i mbeturinave duhet të bashkëpunojë me autoritetin publik dhe kompanitë përgjegjëse për të siguruar një mjeshtëri pastër.

**Neni 10**  
**Mbeturinat e vëllimshme**

1. Çdo person fizik apo juridik i cili gjeneron mbeturina të vëllimshme obligohet që ato t'i ekspozojë në kohën e caktuar për eksposimin e tyre në lagjen në të cilën e posedon pronën.
2. Dërgimi i mbeturinave të vëllimshme në qendra të grumbullimit apo në qendra specifike, mund të realizohet vetëm me njoftim paraprak.
3. Mbeturina të vëllimshme konsiderohen këto kategori:
  - 3.1. Teknika e bardhë;
  - 3.2. Orenditë shtëpiake të të gjitha llojeve.
4. Ofrimi i shërbimit jashtë orarit të paraparë për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme, realizohet përmes angazhimit të kompanive, të cilat kanë kontratë me Komunën e Prishtinës për ofrimin e këtij shërbimi. Ky shërbim do të ketë kosto shtesë konform çmimores së përcaktuar si shtojcë.

**Neni 11**  
**Mbeturinat ndërtimore**

1. Çdo person fizik apo juridik, i cili gjeneron mbeturina nga ndërtimi dhe demolimi, obligohet që para marrjes së lejes ndërtimore apo lejes për renovim, të lidhë kontratë me kompaninë apo kompanitë të cilat kanë kontratë me Komunën e Prishtinës për ofrimin e këtij shërbimi. Pas lidhjes së kësaj kontrate, personi do t'i plotësojë kushtet për t'u pajisur me Leje për menaxhimin e mbeturinave, nga Sektori për menaxhim të mbeturinave dhe ambientit, për ushtrimin e veprimtarisë.
2. Ndalohet transportimi i mbeturinave ndërtimore në territorin e Komunës së Prishtinës pa u pajisur me leje nga Sektori për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit.
3. Leja për transportim të mbeturinave merret për objektin specifik dhe vlen vetëm për atë objekt. Dokumentacionet e kërkova për t'u pajisur me Leje për menaxhim të mbeturinave do të specifikohen nga Sektori për menaxhim të mbeturinave dhe ambientit.

## Neni 12

### Leja mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave

1. Kjo leje zëvendëson licencën për menaxhimin e mbeturinave që më parë është lëshuar nga Ministria e Mjedisit. Kjo leje lëshohet nga Komuna e Prishtinës dhe vlen për operim vetëm në territorin e Komunës së Prishtinës, si dhe ka afat të vlefshmërisë për një periudhë një (1) vjeçare. Leja mund të vazhdohet pas parashtrimit të kërkesës nga kompania përkatëse në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe energjisë eficiente.
2. Në mënyrë që t'i vazhdohet leja kompanisë përkatëse, e njëjta duhet të raportojë rregullisht në Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë, në Sektorin për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, si dhe në Sektorin e mbrojtjes së mjedisit dhe energjisë eficiente në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prishtinës.
3. Leja mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave është dokument i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për të operuar në Komunën e Prishtinës, pasi që për të operuar në territorin e saj secila kompani duhet të ketë Kontratë të lidhur me Komunën e Prishtinës në të cilën precizohen të gjitha çështjet dhe mënyra e operimit të kompanive përkatëse të cilat pajisen me leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave. Kjo leje mund të jetë:
  - 3.1. Leje mjedisore komunale për menaxhim me mbeturina ndërtimore;
  - 3.2. Leje mjedisore komunale për menaxhim me mbeturina të amvisërisë;
  - 3.3. Leje mjedisore komunale për menaxhim me mbeturina të vëllimshme;
  - 3.4. Leje mjedisore komunale për menaxhim me mbeturina specifike si vajra, goma apo të ngjashme;
  - 3.5. Leje mjedisore komunale për menaxhim me mbeturina në hapësira publike, të cilat hasen gjatë pastrimit të rrugëve dhe zbrazjes së shportave të xhepit.
4. Kushtet dhe specifikat që duhet të plotësojnë kompanitë, të cilat aplikojnë për t'u pajisur me këtë leje, do të përcaktohen në aplikacion, në funksion të asaj se për cilin lloj të mbeturinave kërkohet leja.

## Neni 13

### Mbeturinat e rishfrytëzueshme

1. Secili person fizik apo juridik udhëzohet që mbeturinat potencialisht të rishfrytëzueshme t'i dërgojë në qendrat për rishfrytëzim, të cilat do të adoptohen brenda territorit të Komunës së Prishtinës.

**Neni 14**  
**Tarifa dhe mënyra e faturimit të shërbimit të mbeturinave**

1. Secili gjenerues dhe shfrytëzues i shërbimit për mirëmbajtjen e mbeturinave do të tarifohet në bazë të vlerës së përcaktuar me çmimoren e përcaktuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
2. Faturimi i taksës së mbeturinave bëhet në baza mujore, kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave më së largu deri më ditën e dhjetë (10) të muajit pasues.
3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e taksës së mbeturinave për çdo muaj të vitit. Gjeneruesit e mbeturinave mund të bëjnë pagesën edhe në këste si më poshtë:
  - 3.1.Kësti i parë: janar – mars;
  - 3.2.Kësti i dytë: prill – qershori;
  - 3.3.Kësti i tretë: korrik – shtator;
  - 3.4.Kësti i katërt: tetor – dhjetor.
4. Tarifa do të rishikohet çdo dy vjet në muajin qershori nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.
5. Tarifa minimale për një vit kalendarik është 12 euro për pronë, pavarësisht se a është shfrytëzuar shërbimi për mbeturina.
6. Konsumatori do të paguajë konform periudhës së shfrytëzimit të pronës së tij/saj.

**Neni 15**  
**Lirim i nga taksa**

1. Çdo person fizik apo juridik, i cili për një periudhë të caktuar kohore nuk ka nevojë të marrë shërbim të grumbullimit të mbeturinave, duhet të njoftojë paraprakisht Sektorin për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit në Komunën e Prishtinës.
2. Në mënyrë që të lirohet nga pagesa, konsumatori duhet të paraqesë kërkesë në Sektorin për menaxhimin e mbeturinave dhe ambientit, për periudhën kur nuk do ta shfrytëzojë pronën.
3. Në rastin e paraqitjes së kërkesës, konsumatori duhet të ofrojë si dëshmi faturën mbi shpenzimet e rrymës dhe ujit për atë pronë për periudhën e caktuar kohore.
4. Një pronë mund të konsiderohet e pashfrytëzuar, nëse për një periudhë të caktuar nuk ka

shpenzime të rrymës më të mëdha se 40 kw/muaj, si dhe shpenzime të ujit më shumë se 1 m<sup>3</sup> ujë/muaj.

5. Periudha minimale për mosofrim të shërbimit duhet të jetë 3 muaj. Pra, çdo kërkesë përmes së cilës kërcohët lirim nga pagesa për periudhë më të vogël se 3 muaj, nuk mund të merret parasysh.
6. Objektet përcjellëse si garazh, depo jokomerciale, verandë, të cilat nuk shfrytëzohen për banim apo për ushtrimin e ndonjë veprimitarje komerciale nuk do të faturohen.
7. Lirimi nga pagesa do të realizohet në mënyrë retroaktive, pas paraqitjes së kërkesës me dokumentacion si në vijim:
  - 7.1. Njoftimi fillestar i protokolluar para datës kur fillon periudha për të cilën kërcohët lirim nga pagesa;
  - 7.2. Dëshmi nga KEDS & KESCO të gjitha saturat e rrymës të periudhës në fjalë;
  - 7.3. Dëshmi nga KRU, të gjitha saturat e ujit të periudhës në fjalë.
8. Lirohen nga pagesa e faturës së mbeturinave bizneset e vogla artizanale (këpuctarët, rrobaqepësit, orëtarët dhe të ngjashëm), të cilët të vetmin shërbim që e ofrojnë është riparimi i produkteve.

#### **Neni 16**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitet e kompanisë përgjegjëse të kontraktuar për shërbimin e mbeturinave**

1. Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, është i obliguar që të veprojë sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.
2. Operator publik i kontraktuar nga Komuna e Prishtinës është Kompania Regionale e Mbeturinave “Pastrimi” SH.A për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, e cila është e obliguar që të veprojë sipas kontratës dhe ligjeve në fuqi.
3. Komuna e Prishtinës mund të angazhojë kompani tjetër për t’i ndihmuar Kompanisë Regionale të Mbeturinave “Pastrimi” në rast të vështirësive gjatë operimit.

#### **Neni 17**

#### **Veprimet e ndaluara**

1. Me ketë rregullore ndalojen veprimet si më poshtë:

- 1.1. Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjetë publike;
- 1.2. Hedhja e mbeturinave e llojeve tjera në kontejner ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është paraparë;
- 1.3. Hedhja e mbeturinave në hapësirat e përbashkëta, brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkonet, korridoret, tarracat e banesave etj.);
- 1.4. Hedhja e mbeturinave nga ekonomitë familjare dhe nga bizneset, në hapësirat publike jashtë shportave/kontejnerëve të dedikuar për këtë shërbim;
- 1.5. Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme;
- 1.6. Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;
- 1.7. Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe dhe në vende tjera publike);
- 1.8. Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave, pa autorizim të autoriteteve komunale;
- 1.9. Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë ose në pikat mbledhëse apo ndarëse të mbeturinave;
- 1.10. Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshët apo të ngjashme, nga kontejnerët ose nga pikat mbledhëse të mbeturinave;
- 1.11. Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset/veprimtaritë ekonomike, për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin “mbeturina komunale dhe komerciale”;
- 1.12. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë ose në pikat mbledhëse nga personat e paautorizuar;
- 1.13. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;
- 1.14. Derdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve, gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim, në deponi të mbeturinave;
- 1.15. Personat gjatë transportimit të mbeturinave, duhet të marrin masa që automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate, me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit, me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponi të

mbeturinave;

- 1.16. Ndryshimi i mënyrës, metodave, teknikës dhe teknologjisë së largimit të mbeturinave, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me kontratë apo ndonjë formë tjetër;
- 1.17. Hedhja e mbeturinave nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre;
- 1.18. Eksposimi i shportave/ kontejnerëve para objekteve përkatëse, jashtë orarit të përcaktuar nga Komuna e Prishtinës, për grumbullimin e mbeturinave;
- 1.19. Hedhja e bombolave të gazit, gacave, hirit dhe mbeturinave tjera, të cilat potencialisht mund të shkaktojnë zjarr në kontejnerët publik. Këto mbeturina duhet të ekspozohen ndaras në kontejner të veçantë.

**Neni 18**  
**Dispozitat ndëshkuese**

1. Ndaj gjeneruesit të mbeturinave i cili nuk e bën pagesën e tarifës për mbeturina, do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ose procedura përmbarimore përmes përmbaruesve privat.
2. Duke u bazuar në nenin 19 të Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektori komunal shqipton gjoba varësisht nga lloji i shkeljes në përputhje me Ligjin për Mbeturina dhe Ligjin për Kundërvajtje në fuqi.
3. Gjobat për shkeljen e dispozitave të kësaj rregulloreje janë në vlerë prej njëzet (20) euro deri në pesëqind (500) euro si dënim për kundërvajtje ndaj çdo personi fizik për veprimet me mbeturina që shkaktojnë ndotjen e mjedisit dhe dëmtojnë shëndetin e njeriut.
4. Gjobat për shkelësit e përcaktiveve me këtë rregullore janë:
  - 4.1. Me gjobë në vlerë prej tridhjetë (30) euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
    - 4.1.1. Hedh çfarëdolloj mbeturine në rrugë ose në sipërsfaqe publike.
  - 4.2. Me gjobë në vlerë prej katërdhjetë (40) euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
    - 4.2.1. Hedh mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale;
    - 4.2.2. Në kontejner të mbeturinave merr ose shkapërderdh – nxjerr mbeturina prej kontejnerit jashtë;

- 4.2.3. Hedh mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat;
- 4.2.4. Mbeturinat nga copëtimi dhe prerja e drunjve, i lë në rrugë ose në sipërfaqe publike.
- 4.3. Me gjobë në vlerë prej pesëdhjetë (50) euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
- 4.3.1. hedh mbeturina nga automjeti në lëvizje;
  - 4.3.2. hedh mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;
  - 4.3.3. dëmton kontejnerët për mbeturina komunale;
  - 4.3.4. i ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
  - 4.3.5. hedh pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina komunale;
  - 4.3.6. hedh mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërfaqe publike;
  - 4.3.7. hedh mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturina komunale.
- 4.4. Me gjobë në vlerë prej shtatëdhjetë (70) euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:
- 4.4.1. hedh çfarëdolloj mbeturine nga ballkoni ose dritarja e objektit;
  - 4.4.2. hedh mbeturina në pusetat për kanalizim;
  - 4.4.3. hedh mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtë kontejnerëve (ambalazhë letre, metali, plastike dhe materiale të ndryshme);
  - 4.4.4. hedh mbeturina të ngjyrave në kontejner për mbeturina komunale;
  - 4.4.5. hedh mbeturinat medicinale në kontejner për mbeturina komunale;
  - 4.4.6. hedh mbeturina në pronën e tjetrit;
  - 4.4.7. hedh pajisje elektrike dhe elektronike në sipërfaqe publike ose në natyrë;
  - 4.4.8. hedh bateri ose akumulator në sipërfaqe publike ose në natyrë;
  - 4.4.9. hedh cigare të ndezur në kontejnerin për mbeturina komunale;
  - 4.4.10. hedh hirin e nxehthë në kontejnerin për mbeturina komunale.
- 4.5. Me gjobë në vlerë prej dyqind (200) euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 4.5.1. hedh mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeve ose kontejnerëve të caktuar nga autoriteti komunal për mbeturina të materialeve ndërtimore;
- 4.5.2. hedh mbeturina nga materialet ndërtimore në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 4.5.3. hedh mbeturina medicinale në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 4.5.4. hedh mbeturina medicinale jashtë kontejnerëve për këto lloje të mbeturinave;
- 4.5.5. hedh mbeturina të vëllimshme në kontejner për mbeturina komunale, sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 4.5.6. hedh lloj tjetër të mbeturinave në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 4.5.7. hedh mbeturina të përziera me vaj në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 4.5.8. hedh mbeturina drunore nga krasitja e bimëve ose drunjve në kontejnerët për mbeturina;
- 4.5.9. djeg mbeturina komunale në kontejner.

4.6. Me gjobë në vlerë prej pesëqind (500) euro i shqiptohet ndëshkimi personit nëse:

- 4.6.1. hedh mbeturina të vajit në sipërfaqe publike, kanalizim, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.2. hedh mbeturina të përziera me vaj në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.3. hedh mbeturina të gomës dhe goma të automjeteve në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.4. djeg mbeturina komunale në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.5. djeg goma, goma të automjeteve ose mbeturina tjera prej gome në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.6. djeg mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.7. djeg mbeturina të ndryshme prej letre në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.8. djeg vajra ose mbeturina të vajrave në hapësira private, publike, në rrugë ose në natyrë;
  - 4.6.9. derdh çfarëdo materiali në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë në ç'rast prej saj krijohet mbeturinë ose ndotje.
5. Me gjobë në të holla prej dy mijë (2.000) deri në pesë mijë (5.000) euro dënoshet për kundërvajtje çdo person juridik, i cili nuk zbaton rregullat e përcaktuara në këtë rregullore, përkatesisht detyrimet e gjeneruesve të mbeturinave.
5. Për të gjitha shkeljet/kundërvajtjet tjera që nuk janë të përcaktuara në këtë rregullore, do të

shqiptohen gjobat konform Ligjit për Mbeturina në fuqi.

**Neni 19**  
**Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

1. Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe njësitë përkatëse të administratës komunale.
3. Mbikëqyrjen inspektuese për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Drejtoria e Inspeksionit dhe zyrtarë tjerë të autorizuar nga ana e komunës.


**Neni 20**  
**Dispozita shfuqizuese**


1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave Nr. 01.Nr. 110-247315 e datës 03.10.2016.

**Neni 21**  
**HYRJA NË FUQI**

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-030/01-227581/23, më 1.12.2023

**KRYESUES I KUVENDIT**  
Pëllumb Barçinovci  




## SHTOJCA 1 – ÇMIMORJA

### Çmimorja e propozuar për shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave komunale

Kategoria e konsumatorit	Tarifat e propozuara	
	Pa TVSH	Me TVSH 8%
1. Amvisëritë rezidente	5,56 €/muaj	6,20 €/muaj
1. Amvisëritë jorezidente	16.48 €/vit	17,8 €/vit
1.1. Amvisëritë, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave komunale	5,31 €/muaj	5,73 €/muaj
1.2 Amvisëritë, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme	0,25 €/muaj	0,27 €/muaj
2.1 Kategoria I - Dyqanet e vogla dhe artizanale - Zona urbane	7,78 €/muaj	8.4 €/muaj
2.1 Kategoria I - Dyqanet e vogla dhe artizanale - Zona rurale	5,56 €/muaj	6 €/muaj
2.2 Kategoria II - Bizneset e mesme deri tek ato të mëdha, me kosto të ulët të shërbimit - Zona urbane	12,30 €/muaj	15 €/muaj
2.2 Kategoria II - Bizneset e mesme deri tek ato të mëdha, me kosto të ulët të shërbimit - Zona rurale	7.78 €/muaj	8.4 €/muaj
2.3 Kategoria III - Bizneset e mesme deri tek ato të mëdha, me kosto të moderuar të shërbimit - Zona urbane	19,07 €/muaj	20.6 €/muaj
2.3 Kategoria III - Bizneset e mesme deri tek ato të mëdha, me kosto të moderuar të shërbimit - Zona rurale	12,69 €/muaj	13.7 €/muaj
2.4 Kategoria IV - Bizneset e mesme deri tek ato të mëdha, me kosto të lartë të shërbimit - Zona urbane	27.78 €/muaj	30.0 €/muaj
2.4 Kategoria IV - Bizneset e mesme deri tek ato të mëdha, me kosto të lartë të shërbimit - Zona rurale	16.67 €/muaj	18.0 €/muaj
2.5 Kategoria V - Bizneset me kontrata të veçanta 1,1m3	16.67 €/zbrazje	18.0 €/zbrazje
2.5 Kategoria V - Bizneset me kontrata të veçanta 7,1m3	52.89 €/zbrazje	64.50 €/zbrazje
2.6 Institucionet me kontrata të veçanta 1,1m3	16.67 €/zbrazje	18.0 €/zbrazje
2.6 Institucionet me kontrata të veçanta 7,1m3	52.89 €/zbrazje	64.50 €/zbrazje

**Çmimorja e propozuar për shërbimin me porosi për kategori të veçanta në kompetencë të komunës për 1 m<sup>3</sup>**

	<b>Tarifat e propozuara</b>	
	<b>Pa TVSH</b>	<b>Me TVSH 8%</b>
<b>1. Grumbullimi i mbeturinave të vëllimshme</b>	<b>8,7 €</b>	<b>9,4 €</b>
<b>2. Grumbullimi i mbeturinave të ndërtimit, demolimit</b>	<b>9,17 €</b>	<b>9,9 €</b>
<b>3. Grumbullimi i mbeturinave të gjelbra nga kopshtet</b>	<b>9,60 €</b>	<b>9,6 €</b>